FORMULARI I OFERTËSEKONOMIKE²

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomikshënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt: **[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

²Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE³

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomikshënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

c) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;

³Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlereabsolute është si më poshtë:

1	2	3
Nr.	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit e shprehur në vlereabsolute

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti/enti kontraktor përlllogarit çmimin bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

Shtojca3.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë** (në rast BOE): _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në këtë Formularduhet të plotësohen dhe t'u vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerëdo të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	5	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					

Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrimi shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi (nëse batohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]* / Nr. Referencës në faqen e APP-së.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se *[emri i ofertuesit të siguruar]* ka derdhur një depozitë pranë *[emrit dhe adresës së bankës]* / është garantuar pranë *[emrit dhe adresës së kompanisë së sigurimit]* me një vlerë prej *[monedhës dhe vlerës]*, e shprehur në fjalë dhe shifra sikundër përsigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipërtë transferojmë në llogarinë e *[emrit të autoritetit/entit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbylljen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

LOTI 1 - "AUTOMJET FUORISTRADË 4X4 (PICK-UP)"

Viti i prodhimit: Jo më e vjetër se 2015

Gjendja e mjetit: I përdorur

Kambio: Manual ose automatik

Klasa e emetimi të gazrave: Jo më pak se Euro 5

Lenda djegëse: Naftë (diesel)

Nr i dyerve: 4

Konfigurimi i gomave: 4x4

Krahu i timonit: Krahu i majtë

Frenat: I pajisur me sistem ABS

Airbag: I pajisur edhe nga ana e pasagjerit

Ajer te kodicionuar: Po

Cilindrata e motorrit: Jo më pak se 1999 cc

Motorri: Gjendje të mirë pune

Pjesët xhenerike: Gjendje të mire pune

Sistemi i frenimit: Gjendje të mirë pune

Sistemi i drejtimit: Gjendje të mirë pune

Gomat: Gjendje të mirë pune

Karroceria mbrapa: E pajisur me karroceri mbrapa

Kabina dhe kroskoti: E pastër dhe në gjendje të mire

ARGUMENTIMI:

Modeli: Automjet Fuoristradë 4x4 (Pick-up).

Kërkohet automjet i tipit pick-up me sistem lëvizjeje 4x4 për të garantuar lëvizje të sigurt dhe efikase në rrugë të paasfaltuara, terrene të vështira dhe zona rurale, si dhe për transportin e pajisjeve, materialeve dhe personelit në terren.

Viti i prodhimit: Jo më i vjetër se viti 2015.

Ky kriter synon sigurimin e një automjeti me nivel të mirë teknologjik, besueshmëri më të lartë dhe kosto më të ulëta mirëmbajtjeje.

Gjendja e mjetit: E përdorur.

Lejimi i një automjeti të përdorur mundëson optimizimin e fondeve publike duke siguruar një mjet funksional që plotëson nevojat e institucionit me kosto më ekonomike.

Kambio: Manuale ose Automatike.

Pranimi i të dy llojeve të transmisionit shmang kufizimin e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë, pasi të dyja plotësojnë kërkesat funksionale të institucionit.

Klasa e emetimeve të gazrave: Jo më pak se Euro 5.

Ky standard garanton nivel më të ulët të ndotjes së mjedisit.

Lënda djegëse: Naftë (Diesel).

Motori me naftë siguron konsum më ekonomik, çift rrotullues më të lartë dhe performancë më të mirë gjatë transportit të ngarkesave dhe lëvizjes në terrene të vështira.

Numri i dyerve: 4.

Katër dyer mundësojnë akses të lehtë për personelin dhe rrisin funksionalitetin e automjetit gjatë përdorimit në terren.

Konfigurimi i gomave: 4x4.

Sistemi me tërheqje në të katër rrotat është i domosdoshëm për të garantuar lëvizje të sigurt në kushte të vështira atmosferike dhe në terrene me baltë, zhavorr apo pjerrësi.

Pozicioni i timonit: Në anën e majtë.

Ky specifikim është i nevojshëm për përputhjen me rregullat e qarkullimit rrugor në Republikën e Shqipërisë.

Sistemi i frenimit: I pajisur me ABS.

Sistemi ABS rrit sigurinë aktive të automjetit duke parandaluar bllokimin e rrotave gjatë frenimit dhe duke ruajtur kontrollin e drejtimit.

Airbag:

Prania e airbag-ve rrit sigurinë e personelit në rast aksidenti dhe përmbush standardet minimale të sigurisë

Kondicioneri: Funksional.

Kondicioneri garanton kushte të përshtatshme pune për drejtuesin dhe personelin gjatë përdorimit të automjetit në çdo stinë.

Cilindrata e motorit: Jo më pak se 1,999 cc.

Kjo cilindrata siguron fuqi dhe çift rrotullues të mjaftueshëm për transportin e ngarkesave dhe përdorimin e automjetit në terrene të ndryshme.

Motori: Në gjendje të mirë pune.

Motori duhet të funksionojë normalisht, pa defekte apo rrjedhje, për të garantuar besueshmëri dhe vazhdimësi në shërbim.

Pjesët xhenerike: Në gjendje të mirë pune.

Komponentët mekanikë dhe elektrikë duhet të jenë funksionalë për të shmangur ndërprerjet e punës dhe kostot e menjëhershme të riparimit.

Sistemi i frenimit: Në gjendje të mirë pune.

Sistemi i frenimit duhet të jetë plotësisht funksional për të garantuar sigurinë e automjetit dhe të personelit.

Sistemi i drejtimit: Në gjendje të mirë pune.

Sistemi i drejtimit duhet të sigurojë manovrim të sigurt dhe të saktë në çdo kusht pune.

Gomat: Në gjendje të mirë pune.

Gomat duhet të kenë konsum normal dhe thellësi të mjaftueshme të profilit për të garantuar aderencë dhe siguri gjatë lëvizjes.

Karroceria e pasme: E pajisur me platformë ngarkimi

Platforma e pasme është e nevojshme për transportin e materialeve, veglave të punës dhe pajisjeve që përdoren gjatë aktiviteteve në terren.

Kabina dhe karroceria: Të pastra dhe në gjendje të mirë.

Kabina dhe karroceria duhet të jenë pa dëmtime strukturore, pa korrozion të avancuar dhe në gjendje të mirë estetike e funksionale, duke garantuar sigurinë, jetëgjatësinë dhe paraqitjen e automjetit.

LOTI 2 – BLERJE FADROMË

Data e prodhimit: jo më e vjetër se viti 2015.

Mjeti të jetë në gjendje të mirë teknike dhe funksionale, i gatshëm për punë.

2. Motori

Lloji i motorit: Diesel

Numri i cilindrave: 4.

Fuqia motorike: jo më pak se 60 kW.

Sistemi i ftohjes: me ujë.

3. Transmisioni

Minimumi 4 shpejtësi përpara dhe 4 shpejtësi prapa.

Shpejtësia maksimale e lëvizjes: jo më pak se 20 km/h.

4. Sistemi hidraulik

Pompë hidraulike me kapacitet jo më pak se 140 l/min.

Sistemi hidraulik të sigurojë funksionimin normal të kovës ngarkuese dhe krahut gjermues në të gjitha regjimet e punës.

5. Kova ngarkuese

Kapaciteti: jo më pak se 0.8 m³.

Gjerësia: jo më pak se 2.0 m.

Kova e përparme të jetë me hapje (4 në 1), e përshtatshme për ngarkim, nivelim dhe kapje materiale.

6. Pajisjet e punës

Mjeti të pajiset me:

1 (një) kovë gjermuese me gjerësi jo më pak se 250 mm (25 cm).

1 (një) kovë gjermuese me gjerësi jo më pak se 400 mm (40 cm).

Të dyja kovat të jenë të montueshme në mënyrë të sigurt në krahun gjermues, pa pasur nevojë

për modifikime shtesë.

7. Parametra të përgjithshëm

Pesha operative: jo më pak se 7,000 kg.

Kabinë e mbyllur,

Kondicioner (A/C) funksional.

Pasqyra të jashtme dhe ndriçim pune për funksionim në kushte me dukshmëri të ulët.

ARGUMENTIMI:

Data e prodhimit: jo më e vjetër se viti 2015.

Kërkesa synon sigurimin e një mjeti me teknologji relativisht të re, me konsum më të ulët karburanti, kosto më të ulëta mirëmbajtjeje dhe disponueshmëri më të madhe të pjesëve të këmbimit, duke garantuar jetëgjatësi dhe besueshmëri në punë.

Mjeti të jetë në gjendje të mirë teknike dhe funksionale.

Kjo kërkesë garanton që mjeti të jetë menjëherë i gatshëm për përdorim, pa nevojën e ndërhyrjeve të rëndësishme teknike pas dorëzimit.

2. Motori

Motor Diesel.

Motorët diesel ofrojnë çift rrotullues të lartë në regjime të ulëta pune, karakteristikë e domosdoshme për punimet e gërmimit, ngarkimit dhe lëvizjes në terrene të vështira.

4 cilindra.

Konfigurimi me katër cilindra siguron balancë optimale ndërmjet fuqisë, konsumit të karburantit dhe kostove të mirëmbajtjes, duke qenë standard për këtë kategori mjetesh.

Fuqia motorike jo më pak se 60 kW.

Kjo fuqi siguron performancë të mjaftueshme për funksionimin e njëkohshëm të sistemit hidraulik dhe lëvizjes së mjetit gjatë punimeve normale, pa kufizuar konkurrencën ndërmjet prodhuesve.

Ftohje me ujë.

Sistemi i ftohjes me ujë garanton stabilitet termik dhe funksionim të vazhdueshëm gjatë punës intensive në temperatura të ndryshme.

3. Transmisioni

Minimumi 4 shpejtësi përpara dhe 4 prapa.

Ky konfigurim mundëson përshtatjen e shpejtësisë sipas llojit të punës dhe terrenit, duke rritur produktivitetin dhe manovrueshmërinë.

Shpejtësia maksimale jo më pak se 20 km/h.

Siguron transport efikas të mjetit ndërmjet vendeve të punës pa qenë e nevojshme përdorimi i mjeteve shtesë të transportit.

4. Sistemi hidraulik

Pompë hidraulike jo më pak se 140 l/min.

Kapaciteti i pompës garanton furnizim të mjaftueshëm me vaj hidraulik për funksionimin normal të kovës ngarkuese dhe krahut gërmues, duke siguruar cikle pune të shpejta dhe efikase.

Funksionim normal në të gjitha regjimet e punës.

Kërkoheq që sistemi hidraulik të ruajë performancë të qëndrueshme gjatë të gjitha operacioneve të punës.

5. Kova ngarkuese

Kapacitet jo më pak se 0.8 m³.

Ky kapacitet mundëson ngarkimin efikas të dheut, inerteve dhe materialeve të tjera, duke reduktuar numrin e cikleve të punës.

Gjerësi jo më pak se 2.0 m.

Siguron mbulim të mjaftueshëm gjatë nivelimit dhe ngarkimit, duke rritur produktivitetin e mjetit.

Kovë me hapje (4 në 1).

Ky konfigurim rrit funksionalitetin e fadromës, pasi mundëson ngarkim, nivelim, kapje materiale dhe punime pastrimi pa pasur nevojë për pajisje shtesë.

6. Pajisjet e punës

Kovë gërmuese 250 mm dhe kovë gërmuese 400 mm.

Dy përmasat e kovave i japin mjetit fleksibilitet për kryerjen e punimeve të ndryshme, nga gërmimet e ngushta deri te pastrimi dhe profilizimi i kanaleve.

Kërkesa që kovat të montohen pa modifikime shtesë garanton përdorim të menjëhershëm dhe siguri gjatë punës.

7. Parametrat e përgjithshëm

Pesha operative jo më pak se 7,000 kg.

Pesha minimale siguron stabilitet gjatë punimeve të gërmimit dhe ngritjes së materialeve, si dhe performancë më të mirë në terrene të ndryshme.

Kabinë e mbyllur.

Siguron mbrojtje të operatorit nga kushtet atmosferike, pluhuri dhe faktorët e jashtëm gjatë gjithë vitit.

Kondicioner funksional.

Përmirëson kushtet e punës së operatorit, veçanërisht gjatë periudhave me temperatura të larta, duke ndikuar pozitivisht në produktivitet dhe sigurinë në punë.

Pasqyra të jashtme dhe ndriçim pune.

Rrisin sigurinë gjatë manovrimit dhe mundësojnë punën në kushte me dukshmëri të kufizuar ose gjatë orëve të mbrëmjes.

LOTI 3 – BLERJE KAMIONÇINË ME PLATFORMË AJRORE (KOSH) DHE VINÇ HIDRAULIK

- Viti i prodhimit: jo më i vjetër se viti 2015.
- Standardi i emetimeve: minimumi Euro 5.
- Fuqia e motorit: jo më pak se 90 kW (120 HP).
- Transmisioni: manual ose automatik.
- Lenda djegese: Naftë (Diesel)
- Kilometrazhi: jo më shumë se 250,000 km.
- Numri i vendeve: jo më pak se 3 (shofer + 2 pasagjerë).
- Kondicioner funksional..
- Krah i timonit: Krah i majte

PLATFORMA AJRORE (KOSHI)

- Lartësia e platformës: jo më pak se 16 metra.
- Shtirja horizontale: jo më pak se 6 metra.
- Kapaciteti mbajtës i koshit: jo më pak se 200 kg.

VINÇI HIDRAULIK

- Tipi: Vinç hidraulik i montuar në automjet.

ARGUMENTIMI:

Viti i prodhimit: jo më i vjetër se viti 2015.

Kërkohet një automjet me vitë relativisht të ri për të garantuar jetëgjatësi, besueshmëri teknike, siguri në përdorim dhe kosto më të ulëta të mirëmbajtjes.

Standardi i emetimeve: minimumi Euro 5.

Ky standard garanton reduktimin e ndotjes së mjedisit

Fuqia e motorit: jo më pak se 90 kW (120 HP).

Fuqia e kërkuar është e nevojshme për të garantuar lëvizjen e sigurt të automjetit së bashku me platformën ajrore, vinçin hidraulik, personelin dhe pajisjet e punës, edhe në terrene me pjerrësi.

Transmisioni: Manual ose Automatik.

Pranohen të dy llojet e transmisionit për të mos kufizuar konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë, pasi të dyja plotësojnë kërkesat funksionale.

Lënda djegëse: Naftë (Diesel).

Motorët me naftë ofrojnë konsum më ekonomik, çift rrotullues më të lartë dhe janë më të përshtatshëm për automjete pune.

Kilometrazhi: jo më shumë se 250,000 km.

Ky kufizim synon të sigurojë që automjeti të ketë konsum normal të komponentëve mekanikë dhe jetë të mbetur të konsiderueshme në shërbim.

Numri i vendeve: jo më pak se 3 (shofer + 2 pasagjerë).

Automjeti duhet të mundësojë transportin e ekipit të punës së bashku me drejtuesin e mjetit.

Kondicioner funksional.

Siguron kushte normale pune për personelin gjatë përdorimit të automjetit në çdo stinë.

Pozicioni i timonit: në anën e majtë.

Kërkohet për përputhshmëri me rregullat e qarkullimit rrugor në Republikën e Shqipërisë.

Lartësia e punës: jo më pak se 16 metra.

Kjo lartësi mundëson kryerjen e punimeve në shtyllat e ndriçimit publik, sinjalistikë, fasada, pemë dekorative dhe objekte të tjera infrastrukturore pa nevojën e pajisjeve shtesë.

Shtrirja horizontale: jo më pak se 6 metra.

Shtrirja horizontale lejon arritjen e pikave të punës pa qenë e nevojshme zhvendosja e shpeshtë e automjetit, duke rritur efikasitetin dhe sigurinë.

Kapaciteti mbajtës i koshit: jo më pak se 200 kg.

Ky kapacitet mundëson transportimin e dy operatorëve ose një operatori me veglat dhe materialet e nevojshme për kryerjen e punimeve.

LOTI 4 – BLERJE KAMIONÇINË VETËSHKARKUESE (DOPIO KABINË)

1. Viti i prodhimit: Jo më herët se viti 2015.
2. Kilometrazhi: Jo më shumë se 250,000 km.
3. Fuqia e motorit: Jo më pak se 85 kW (116 HP).
4. Lënda djegëse: Naftë.
5. Standardi i emetimeve: Jo më pak se Euro 5 ose ekuivalent.
6. Numri i akseve: 2 akse.
7. Sistemi i frenimit: ABS.
8. Transmisioni: Manual ose Automatik.
9. Numri i cilindrave: Jo më pak se 4.
10. Karrocëria: Vetëshkarkuese .
11. Gjatësia totale e mjetit: Jo më pak se 5.0 m.
12. Gjerësia totale e mjetit: Jo më pak se 2.0 m.
13. Numri i vendeve: Jo më pak se 6 (Dopio Kabinë).
14. Peshë: Jo më pak se 3,500 kg.
15. Kapaciteti i ngarkesës: Jo më pak se 1,000 kg.

16. Gjatësia e karrocerisë: Jo më pak se 2.5 m.

17. Gjerësia e karrocerisë: Jo më pak se 1.8 m.

18. Pozicioni i timonit: Në anën e majtë.

19. Mjeti duhet të jetë në gjendje shumë të mirë teknike, mekanike dhe vizuale, pa dëmtime strukturore, pa korrozion të avancuar, me sistemin hidraulik të karrocerisë plotësisht funksional, motorin, transmisionin dhe sistemin e frenimit në gjendje pune, si dhe me goma në gjendje të mirë.

ARGUMENTIMI:

Viti i prodhimit: Jo më herët se viti 2015.

Argumentim: Kërkohej një mjet me teknologji relativisht të re për të garantuar jetëgjatësi, besueshmëri në shërbim, kosto më të ulëta mirëmbajtjeje dhe përputhje me standardet bashkëkohore të sigurisë dhe emetimeve.

Kilometrazhi: Jo më shumë se 250,000 km.

Argumentim: Kufizimi i kilometrazhit synon të sigurojë që mjeti të mos jetë i konsumuar në mënyrë të konsiderueshme, duke ulur rrezikun e defekteve dhe kostot e mirëmbajtjes gjatë përdorimit.

Fuqia e motorit: Jo më pak se 85 kW (116 HP).

Argumentim: Kjo fuqi është e nevojshme për transportimin e ngarkesave në kushte të ndryshme pune, përfshirë rrugët rurale dhe terrenet me pjerrësi, pa kompromentuar performancën.

Lënda djegëse: Naftë.

Argumentim: Motorët me naftë ofrojnë konsum më ekonomik të karburantit dhe çift rrotullues më të lartë, karakteristika të domosdoshme për automjetet e transportit të ngarkesave.

Standardi i emetimeve: Jo më pak se Euro 5 ose ekuivalent.

Argumentim: Ky standard siguron reduktimin e ndotjes së mjedisit.

Numri i akseve: 2 akse.

Argumentim: Konfigurimi me dy akse është i përshtatshëm për llojin e punimeve të parashikuara, duke ofruar manovrim të mirë, kapacitet të mjaftueshëm mbajtës dhe kosto më të ulëta operimi.

Sistemi i frenimit: ABS.

Argumentim: Sistemi ABS rrit sigurinë gjatë frenimit, duke parandaluar bllokimin e rrotave dhe duke ruajtur kontrollin e automjetit në kushte të ndryshme rrugore.

Transmisioni: Manual ose Automatik.

Argumentim: Lejimi i të dy varianteve siguron konkurrencë më të gjerë ndërmjet operatorëve ekonomikë, ndërkohë që të dy llojet përmbushin kërkesat funksionale të institucionit.

Numri i cilindrave: Jo më pak se 4.

Argumentim: Motori me të paktën katër cilindra garanton fuqi, qëndrueshmëri dhe jetëgjatësi të përshtatshme për përdorim intensiv.

Karroceria: Vetëshkarkuese

Argumentim: Karrocera vetëshkarkuese është e domosdoshme për transportin dhe shkarkimin e materialeve si dheu, zhavorri, inertet dhe materiale të tjera pa përdorur pajisje shtesë.

Gjatësia totale e mjetit: Jo më pak se 5.0 m.

Argumentim: Kjo gjatësi garanton stabilitet në lëvizje dhe mundësi për montimin e një karrocerie me kapacitet të përshtatshëm pune.

Gjerësia totale e mjetit: Jo më pak se 2.0 m.

Argumentim: Gjerësia siguron stabilitet gjatë transportit dhe shkarkimit të materialeve, si dhe hapësirë të mjaftueshme për kabinën dopio.

Numri i vendeve: Jo më pak se 6 (Dopio Kabinë).

Argumentim: Kabina dopio mundëson transportimin njëkohësisht të ekipit të punës dhe pajisjeve të nevojshme, duke rritur efikasitetin operacional.

Pesha: Jo më pak se 3,500 kg.

Argumentim: Një peshë minimale e këtij niveli tregon se mjeti është projektuar për punë të rënda dhe garanton qëndrueshmëri gjatë transportit të ngarkesave.

Kapaciteti i ngarkesës: Jo më pak se 1,000 kg.

Argumentim: Ky kapacitet është i nevojshëm për transportimin e materialeve dhe pajisjeve të përdorura në aktivitetet e institucionit pa tejkaluar kufijtë teknikë të automjetit.

Gjatësia e karrocërisë: Jo më pak se 2.5 m.

Argumentim: Siguron hapësirë të mjaftueshme për transportin e materialeve dhe pajisjeve me dimensione të ndryshme.

Gjerësia e karrocërisë: Jo më pak se 1.8 m.

Argumentim: Mundëson kapacitet më të madh transporti dhe rrit efikasitetin gjatë kryerjes së punimeve.

Pozicioni i timonit: Në anën e majtë.

Argumentim: Kjo kërkesë garanton përputhshmëri me legjislacionin shqiptar.

Gjendja teknike e mjetit.

Argumentim: Kërkohet që automjeti të jetë në gjendje shumë të mirë teknike, mekanike dhe vizuale për të siguruar funksionim të pandërprerë, siguri gjatë përdorimit, ulje të kostove të riparimit dhe jetëgjatësi në shërbim.

Dokumentacioni për regjistrim në Republikën e Shqipërisë.

Argumentim: Mjeti duhet të shoqërohet me dokumentacionin e plotë dhe të rregullt për të mundësuar regjistrimin dhe vënien në përdorim sipas legjislacionit shqiptar, pa pengesa administrative apo ligjore.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT**Sasia e mallit që kërkohet:**

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1	LOTI 1 Blerje Automjet Fuoristradë 4x4 (Pick-up).	1 copë	NPP	30 ditë pune nga data e nënshkrimit të kontratës.
2	LOTI 2 Blerje Fadromë	1 copë	NPP	30 ditë pune nga data e nënshkrimit të kontratës.
3	LOTI 3 Blerje Kamionçinë me platformë ajrore (kosh) dhe vinq hidraulik	1 copë	NPP	30 ditë pune nga data e nënshkrimit të kontratës.
4	LOTI 4 Blerje Kamionçinë Vetëshkarkuese (Dopio Kabinë)	1 copë	NPP	30 ditë pune nga data e nënshkrimit të kontratës.

Afatet e lëvrimit: 12 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2.KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT – PËR TË 4 LOTET:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

- EN-ISO 9001-2015 “Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë”ose ekuivalente, e vlefshme dhe të perputhet me mallin objekt prokurimi.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga Operatori Ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2023 ,2024, 2025) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.
- Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.
- Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

- **2.2.2** Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore për vitet financiare 2023,2024,2025, të konfirmuara nga organet tatimore, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit).

Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

2.3.Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më pak se 40% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe mallrat e furnizuara

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe mallrat e furnizuara.

LOTI 1 - BLERJE AUTOMJET FUORISTRADË 4X4 (PICK-UP).

3.Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog(në gjuhën shqipe origjinal ose i përkthyer dhe i noterizuar) për mjetet objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen e specifikimeve teknike dhe standarteve të kërkuara.

- Në katalogun/skedën teknike përkatëse të jetë specifikuar produkti që është paraqitur në ofertë dhe specifikimet teknike.
- Në katalog/skedë teknike duhet të pasqyrohen të dhënat e mjetit, modeli, viti i prodhimit i tij si edhe çdo e dhenë tjetër teknike.
- Mjeti duhet të jetë i shoqëruar me Foto të tij ku tregojnë gjendjen aktuale.

3.1 Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë një vetëdeklarim nëpërmjet të cilës marrin përsipër që garancia për eliminimin, pa shpërblim, të defekteve të mundshme do të jetë 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e marrjes së mjetit në dorëzim, (përfshihen rastet kur vërtetohet se defekti është shkaktuar nga pakujdesia e shoferit ose keqpërdorimi i mjetit”).

3.2 Për mjetet, operatori ekonomik duhet të paraqes dokumentacionin si më poshtë:

- Deklaratën doganore të mjetit, e cila vërteton shlyerjen e detyrimeve doganore në R.SH.
- Dokumentacionin e origjinës të mjetit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur dhe me paraqitjen e një deklarate se dokumentacioni i kërkuar do të dorëzohet fizikisht pranë AK përpara lidhjes së kontratës në rast të shpalljes fitues të operatorit ekonomik.

3.3 Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë se nëse shpallet fitues do të mbulojnë të gjitha shpenzimet për kalimin e pronësisë së mjeteve në emër të AK “Ndërmarrja e Pasurisë Publike”.

3.4 Operatori Ekonomik i shpallur fitues përpara nënshkrimit të kontratës duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës për mjetet si mëposhtë:

- Leje qarkullimi
- Siguracion TPL
- Kontroll teknik i vlefshëm me cilësinë “KALON”

Kriteri konsiderohet i përmbushur dhe me paraqitjen e një deklaratë se dokumentacioni i kërkuar do të dorëzohet fizikisht pranë AK përpara lidhjes së kontratës në rast të shpalljes fitues të operatorit ekonomik.

3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportimit të mjeteve në adresën e Autoritetit Kontraktor.

LOTI 2 - BLERJE FADROMË

4.Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog/skedë teknike(në gjuhën shqipe origjinal ose i përkthyer dhe i noterizuar) për mjetet objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen e specifikimeve teknike dhe standarteve të kërkuara.

- Në katalogun/skedën teknike përkatëse të jetë specifikuar produkti që është paraqitur në ofertë dhe specifikimet teknike.
- Në katalog/skedë teknike duhet të pasqyrohen të dhënat e mjetit, modeli, viti i prodhimit i tij si edhe çdo e dhenë tjetër teknike.
- Mjeti duhet të jetë i shoqëruar me Foto të tij ku tregojnë gjendjen aktuale.

4.1 Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë një vetëdeklarim nëpërmjet së cilës merr përsipër që garancia për eliminimin, pa shpërblim, të defekteve të mundshme do të jetë 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e marrjes së mjetit në dorëzim, (përjashtohen rastet kur vërtetohet se defekti është shkaktuar nga pakujdesia e shoferit ose keqpërdorimi i mjetit)”.

4.2 Për mjetin, operatori ekonomik duhet të paraqes dokumentacionin si më poshtë:

- Deklaratën doganore të mjetit, e cila vërteton shlyerjen e detyrimeve doganore në R.SH.
- Dokumentacionin e origjinës të mjetit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur dhe me paraqitjen e një deklaratë se dokumentacioni i kërkuar do të dorëzohet fizikisht pranë AK përpara lidhjes së kontratës në rast të shpalljes fitues të operatorit ekonomik.

4.3 Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë se nëse shpallet fitues do të mbulojnë të gjitha shpenzimet për kalimin e pronësisë së mjetit në emër të AK “Ndërmarrja e Pasurisë Publike”.

4.4 Operatori Ekonomik i shpallur fitues përpara nënshkrimit të kontratës duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës për mjetin si mëposhtë:

- Leje qarkullimi

-Siguracion TPL

-Kontroll teknik i vlefshëm me cilësinë “KALON”

Kriteri konsiderohet i përmbushur dhe me paraqitjen e një deklaratë se dokumentacioni i kërkuar do të dorëzohet fizikisht pranë AK përpara lidhjes së kontratës në rast të shpalljes fitues të operatorit ekonomik

4.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportimit të mjetit në adresën e Autoritetit Kontraktor.

LOTI 3 - BLERJE KAMIONÇINË ME PLATFORMË AJRORE (KOSH) DHE VINÇ HIDRAULIK

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog/skedë teknike (në gjuhën shqipe origjinal ose i përkthyer dhe i noterizuar) për mjetet objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen e specifikimeve teknike dhe standarteve të kërkuara.

- Në katalogun/skedën teknike përkatëse të jetë specifikuar produkti që është paraqitur në ofertë dhe specifikimet teknike.
- Në katalog/skedë teknike duhet të pasqyrohen të dhënat e mjetit, modeli, viti i prodhimit i tij si edhe çdo e dhenë tjetër teknike.
- Mjeti duhet të jetë i shoqëruar me Foto të tij ku tregojnë gjendjen aktuale.

5.1 Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë një vetëdeklarim nëpërmjet së cilës merr përsipër që garancia për eliminimin, pa shpërblim, të defekteve të mundshme do të jetë 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e marrjes së mjetit në dorëzim, (përfshihen rastet kur vërtetohet se defekti është shkaktuar nga pakujdesia e shoferit ose keqpërdorimi i mjetit)."

5.2 Për mjetin, operatori ekonomik duhet të paraqes dokumentacionin si me poshtë:

- Deklaratën doganore të mjetit, e cila vërteton shlyerjen e detyrimeve doganore në R.SH.
- Dokumentacionin e origjinës të mjetit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur dhe me paraqitjen e një deklaratë se dokumentacioni i kërkuar do të dorëzohet fizikisht pranë AK përpara lidhjes së kontratës në rast të shpalljes fitues të operatorit ekonomik.

5.3 Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë se nëse shpallet fitues do të mbulojnë të gjitha shpenzimet për kalimin e pronësisë së mjetit në emër të AK “Ndërmarrja e Pasurisë Publike”.

5.4 Operatori Ekonomik i shpallur fitues përpara nënshkrimit të kontratës duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës për mjetin si mëposhtë:

- Leje qarkullimi

-Siguracion TPL

-Kontroll teknik i vlefshëm me cilësinë “KALON”

-Kolaudim i vlefshëm i tahogرافit

Kriteri konsiderohet i përmbushur dhe me paraqitjen e një deklaratë se dokumentacioni i kërkuar do të dorëzohet fizikisht pranë AK përpara lidhjes së kontratës në rast të shpalljes fitues të operatorit ekonomik

5.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportimit të mjetit në adresën e Autoritetit Kontraktor.

LOTI 4 - BLERJE KAMIONÇINË VETËSHKARKUESE (DOPIO KABINË)

6.Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog/skedë teknike(në gjuhën shqipe origjinal ose i përkthyer dhe i noterizuar) për mjetet objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen e specifikimeve teknike dhe standarteve të kërkuara.

- Në katalogun/skedën teknike përkatëse të jetë specifikuar produkti që është paraqitur në ofertë dhe specifikimet teknike.
- Në katalog/skedë teknike duhet të pasqyrohen të dhënat e mjetit, modeli, viti i prodhimit i tij si edhe çdo e dhenë tjetër teknike.
- Mjeti duhet të jetë i shoqëruar me Foto të tij ku tregojnë gjendjen aktuale.

6.1 Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë një vetëdeklarim nëpërmjet së cilës merr përsipër që garancia për eliminimin, pa shpërblim, të defekteve të mundshme do të jetë 12(dymbëdhjetë) muaj nga data e marrjes së mjetit në dorëzim, (përfshihen rastet kur vërtetohet se defekti është shkaktuar nga pakujdesia e shoferit ose keqpërdorimi i mjetit)."

6.2 Për mjetin, operatori ekonomik duhet të paraqes dokumentacionin si me poshtë:

- Deklaratën doganore të mjetit, e cila vërteton shlyerjen e detyrimeve doganore në R.SH.
- Dokumentacionin e origjinës të mjetit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur dhe me paraqitjen e një deklaratë se dokumentacioni i kërkuar do të dorëzohet fizikisht pranë AK përpara lidhjes së kontratës në rast të shpalljes fitues të operatorit ekonomik.

6.3 Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë se nëse shpallet fitues do të mbulojnë të gjitha shpenzimet për kalimin e pronësisë së mjetit në emër të AK "Ndërmarrja e Pasurisë Publike".

6.4 Operatori Ekonomik i shpallur fitues përpara nënshkrimit të kontratës duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës për mjetin si mëposhtë:

- Leje qarkullimi

-Siguracion TPL

-Kontroll teknik i vlefshëm me cilësinë "KALON"

-Kolaudim i vlefshëm i tahogرافit

Kriteri konsiderohet i përmbushur dhe me paraqitjen e një deklaratë se dokumentacioni i kërkuar do të dorëzohet fizikisht pranë AK përpara lidhjes së kontratës në rast të shpalljes fitues të operatorit ekonomik

6.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportimit të mjetit në adresën e Autoritetit Kontraktor.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca9.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

- I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----

Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
